



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS
01.Nr. 020-1769, Dt. 26.11.2008

Në bazë të nenit 5, pika 5.2 të Ligjit për ndërmarrje publike 03/L - 087 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 31), të dispozitave të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/L -040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Kryetari i Komunës së Prishtinës merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE NË KOMISIONET E AKSIONARËVE PËR
NDËRMARRJET PUBLIKE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

Neni 1

CAKTOHEN anëtarët e komisioneve të aksionarëve për ndërmarrjet publike të Komunës së Prishtinës: ndërmarrjes publike "Termokos", Ndërmarrjes Publike Banesore, ndërmarrjes publike "Pastrimi", ndërmarrjes publike "Hortikultura", ndërmarrjes publike "Trafiku Urban" dhe ndërmarrjes publike "Sport Marketing".

Neni 2

Anëtarët e komisioneve të aksionarëve të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi, do të jenë në përbërje: një anëtar të cilin e cakton Kryetari i Komunës dhe dy anëtarë të cilët i emëron Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Anëtarë të komisioneve, të caktuar nga Kryetari i Komunës, janë:

a) Ndërmarrja publike "Termokos":

Naim Hoxha

b) Ndërmarrja Publike Banesore:

Shefqet Sylejmani

- c) Ndërmarrja publike "Pastrimi":
Aziz Pacolli
- d) Ndërmarrja publike "Hortikultura":
Amir Ahmeti
- e) Ndërmarrja publike "Trafiku Urban":
Avdurrahman Krasniqi
- f) Ndërmarrja publike "Sport - Marketing":
Nevzat Hydaverdi

Neni 4

Anëtarët e aksionarëve kanë të drejtë të veprojnë në emër të Kryetarit të Komunës dhe duhet të veprojnë në përputhje me Ligjin e ndërmarrjeve publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KRYETARI I KOMUNËS
Prof.dr. Isa Mustafa